



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.04.2026, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdyrrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

**Të pranishëm të tjerë:** Halil Thaqi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, zyrtarët komunal dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP me nr. 05-104/02-10071/26 për shfuqizimin e shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të Pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënie në shrytëzim për vitin 2026
4. Raporti financiar i shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026
5. Shqyrtimi i kërkesës me nr.08-104/02-10362/26 për iniciimin e procedurës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Obiliqit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivel komunal
6. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.02-060-01-6636-26 për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve t ë NPL "Kastrioti" SH.A.
7. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.01-060/01-6641/26 për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve t ë kompanis ë KRM "Pastrimi"
8. Shqyrtimi i kërkesës së Besnik Mjekut me nr.01-070/05-0008052/26 e dt.24.03.2026 për përkrahje financiare të Klubit FC KEK
9. Shqyrtimi i kërkesës së Nasuf Hoxhës me nr.01-070/05-0008079/26 e dt. e dt.24.03.2026 për rishikimin e shpronësimit të lokaleve afariste A4, A5 dhe A6
10. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi plotësim - ndryshimin në rendin e ditës, pasi që në ndërkohë kanë ardhë 2 kërkesa, një nga Kryetari dhe tjetra nga DEFZH-ja. Kërkesa e Kryetarit ka të bëjë me marrjen e vendimit për subvencionimin e transportit publik, ndërsa kërkesa e DEFZH-së ka të bëjë me bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026.

**Kryetari** – Para se të miratohet rendi i ditës, ju lus të keni mirëkuptim, përveç këtyre 2 pikave që do të përfshihen në rend dite, të keni mirëkuptim edhe për 2 pika tjera. Ju e dini se dje është kryer debati publik për Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, dhe ju falenderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Duke pasë parasysh rëndësinë e kësaj sfide që e kemi për mbledhjen e mbeturinave, ju lus ti rekomandoni Kuvendit që në mbledhjen e dt.29.04.2026 të aprovohet Rregullorja në fjalë. Po ashtu, për me mund me operacionalizue këtë Rregullore dhe planin tonë për mbeturina, neve na duhet me ia dhënë në shfrytëzim një pronë NPL "Kastriotit" në kuadër të së cilës do të jetë Departamenti i mbledhjes së mbeturinave. Këtu, kërkoj të futet në rend dite propozim -vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim përbrenda institucionit.

**Kryesuesi** – Duke u bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal neni 2, neni 28 paragrafi 2 lejon dhe i jepë legjitimitet të plotë të drejtës së Kryetarit për të kërkuar shtimin e pikave para miratimit të rendit të ditës. Pra, ndryshim plotësimi i rendit të ditës propozohet të jetë në pikën 4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimit për subvencionimin e transportit publik, pika 5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara nga viti 2025 në vitin 2026, pika 6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e plotësim ndryshimit të Rregullores së mbeturinave, pika 7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për NPL "Kastrioti" SH.A. Përveç, këtij propozimi për ndryshim plotësim të rendit të ditës pikat tjera, mbeten ashtu si janë me radhë.

Miratohet rendi i ditës me 7 vota, për me plotësim ndryshimin e cekur më lartë.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota, për.

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, me nr. 05-104/02-10071/26 për shfuqizimin e shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të Pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënien në shrytëzim për vitin 2026.

**Fjolla Nasufi** – Ne nuk kemi pyetje dhe ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kërkesës në fjalë.

**Vlora Mjekiqi Kabashi** – Nuk kam ndonjë pyetje sepse aty veç është dhënë një sqarim pak a shumë dhe jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, për shfuqizimin e shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të Pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënie në shrytëzim për vitin 2026.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimit për subvencionimin e transportit publik.

**Fjolla Nasufi** – Ne e mbështesim kërkesën e Kryetarit dhe ia rekomandojmë Kuvendit Komunal.

**Vlora Mjekiqi Kabashi** – Kryetarit ia mundëson ligji sa herë të ketë nevojë, kur është në të mirën e qytetarëve, të bëjë plotësim ndryshim në rendin e ditës, kështu që e mbështesë kërkesën e Kryetarit dhe ia rekomandoj Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për marrjen e vendimit për subvencionimin e transportit publik.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

**Fjolla Nasufi** – Edhe këtë pikë ia rekomandojmë Kuvendit Komunal.

**Vlora Mjekiqi Kabashi** - Patjetër që ia rekomandojmë Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për miratimin e plotësim ndryshimit të Rregullores për mbeturina.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës të Kryetarit për miratimin e plotësim ndryshimit të Rregullores së mbeturinave.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin dhe miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për NPL "Kastrioti" SH.A. E pyes drejtorin e DPUKP-së, se a është duke u bërë propozimvendimi dhe a ka mundësi të kryhet para se ti dërgojmë rekomandimet për mbledhjen e Kuvendit.

**Gazmend Krasniqi** – Po, është në proces duke u përgatitë materiali.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për NPL "Kastrioti" SH.A.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti raportin financiar të shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa ,me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e raportit financiar të shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën e DSHMS-së, për iniciimin e procedurës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Obiliqit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivel komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota, për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DSHMS-së, për iniciimin e procedurës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Obiliqit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivel komunal.

#### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të NPL "Kastrioti" SH.A.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Ne kemi të bëjmë me 2 vendime, vendimi për zgjedhjen dhe vendimi për pagesën. Në bazë të disa ligjeve dhe Rregulloreve që i kam lexuar, realisht kjo nuk është kompetencë e Ministrisë me kthye përgjegjen në këto raste sepse Ndërmarrjet publike i kanë të hyrat vetanake dhe e menaxhojnë punën e vetë. Në këtë rast Ministria e ekonomisë e ka kthye përgjigjen, por nuk e di sa është përgjegjësi dhe ne mund të mos pajtohemi me dërgue në Gjykatë vendimin, por nuk dojmë të shkojmë në atë drejtim. Mendoj se ne duhet të marrim vendim për shfuqizim të vendimit për pagesë dhe me lënë një pasues se i mbetet Ndërmarrjes, në vullnetin e tyre ose Rregulloret e brendshme të saj nëse, ka mundësi me i pague aksionarët, sepse një angazhim me aq përgjegjësi i aksionarëve, që është nuk mundesh me kërkue që mos me pasë pagesë. Në këtë rast kryesues kishte me qenë mirë me rishiku këtë çështje.

**Kryesuesi** – Fillimisht kanë qenë 2 vendime, vendimet për formimin e Komisionit të aksionarëve janë kthye pozitivisht sipas ligjit ndërsa, te këto më kanë çuditë edhe mua se paraprakisht më kanë dhënë udhëzime që të shkojnë në atë formë. Ne mund ti shfuqizojmë vendimet dhe në fund ta formulojmë një pasues që ti mbetet institucionit ti gjejë format e pagesës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota ,për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të NPL "Kastrioti" SH.A.

#### **Pika 11 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve Komunal të aksionarëve të Kompanisë KRM "Pastrimi".

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota ,për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të Kompanisë KRM "Pastrimi".

**Pika 12 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Besnik Mjekut për përkrahje financiare të Klubit FC KEK. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota, kërkesën e Besnik Mjekut ia rekomanduan për shqyrtim DEFZH-së dhe Drejtorisë së Kulturës dhe në mbledhjen e Kuvendit Drejtoritë përkatëse të vijnë me një shpjegim.

**Pika 13 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën e Nasuf Hoxhës për rishikimin e shpronësimit të lokaleve afariste A4, A5 dhe A6.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota, për ia rekomanduan DPUKP-së kërkesën e Nasuf Hoxhës për rishikimin e shpronësimit të lokaleve afariste A4, A5 dhe A6.

**Pika 14 e rendit të ditës**

**Labinot Mirena** – E pyes DSHMS-në për çështjen e barnatoreve se ku ka mbetë sepse po bëhet gati një muaj për orarin e tyre të kujdestarisë që është pas orës 22:00. Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e ambientit lidhur me parkun që është mbi çerdhe që vetëm sa u patën rrënue ato objekte dhe tash as nuk po mirëmbahet mirë, as nuk ka ndonjëfarë investimi në të, a parashihet ndonjë investim sivjet në këtë parkun këtu afër Komunës.

**Albertina Dedinca** – Në takimet që i patëm me barnatoret, me aq sa kam kuptue 2 prej tyre dojnë me u mbyllë, vetëm po pres edhe pak disa ditë, sepse pastaj ndërrohet edhe funksionimi i orarit të ndërrimit të natës që dojnë me bë, sepse ndryshe është kur i ke 6 barnatore, e ndryshe është kur i ke 4 barnatore. Pra, po pres edhe pak se çka po ndodhë me këto 2 barnatore,sepse jam shumë e sigurtë për informacionin se po dojnë të tërhiqen, do të thotë të shohim a po qëndrojnë ende apo po mbyllen, pastaj do ta marrim një vendim në koordinim me ata.

**Kryesuesi** – Pyes se cilat janë modulet që ju parashihni, çka do të bëhet dhe si e keni gjetë këtë si vendim përfundimtar.

**Albertina Dedinca** – Me ndërrim të orarit të QKMF-së, kam mendue si zgjidhje me rritë orarin ndoshta, deri në 2 ose 3 të mëngjezit. Njëherë e patëm deri në 12 por tash meqenëse e ndërruam edhe orarin e QKMF-së, po shohë me i përshtatë të gjitha bashkë me njëra tjetrën që me qenë të ndërlidhura. Mirëpo, pa folë edhe njëherë me përfaqësuesit e barnatoreve ndonëse në fund të ditës vendimi i takon Ekzekutivit, por pak me u konsultue me ata që me gjetë një modul të përshtatshëm sepse është vështirë me qenë vetëm 4 barnatore 7 ditë të javës, kujdestari iu bjen 2,3 herë në javë. Prandaj, duhet me pa edhe njëherë mundësinë sa më të përshtatshme për të gjithë.

**Kryesuesi** – Lidhur me orarin e ri ne kemi pranuar një kërkesë nga shefja e grupit të LDK-së, që edhe për këtë çështje të jeni e përgatitur në seancë të Kuvendit.

**Rinor Kurteshi** – Sa i përket pyetjes për lokacionin mbi çerdhen, e kemi një projekt gati në përfundim dhe së shpejti do të realizohet.

Mbledhja përfundoi në ora 11:54'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesues i Komitetit

Samir Ahmeti